URDHËR
Nr. 65, datë 12.3.2026

PËR DELEGIMIN DHE DISA RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 28, 29 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme në proceset gjyqësore, kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen për aparatin nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, kur thirret si palë në gjykim në proceset gjyqësore, në të cilat institucioni i varësisë ka lidhje me objektin e padisë, lëshohen në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë, nga drejtuesi i institucionit qendror ose i varësisë, sipas vendit ku është ngritur kërkesëpadia.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri, si pjesë përbërëse e tij.

4. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor bëhet nga juristë dhe specialistë të fushës, sipas objektit të kërkesëpadisë, nëpërmjet autorizimit të lëshuar nga autoritetet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij urdhri.

5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Punëve të Brendshme në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit, si dhe të drejtën për të hartuar, dorëzuar dhe nënshkruar kërkesëpadi.

6. Përfaqësuesit e autorizuar të ndjekin me korrektësi seancat gjyqësore, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre e, veçanërisht, kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, prapësimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin mbrojtjen e përpiktë të interesave të institucionit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

7. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda një afati 5-ditor nga shpallja/njoftimi i vendimit, të paraqitet informacion i detajuar, i shoqëruar (aty ku është e mundur) me vendimet përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

8. Ngarkohen të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme, qendrore dhe vendore, të caktojnë një person përgjegjës, si pikë kontakti për të shkëmbyer çdo njoftim për ecurinë dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore.

9. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm deri në miratimin e këtij urdhri, të cilat janë përdorur ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrit nr. 152, datë 26.9.2025, "Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme", do të shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

10. Ngarkohen institucionet e varësisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme, drejtoria që mbulon çështjet gjyqësore për aparatin dhe Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.

11. Ngarkohet Sektori i Arkiv-protokollit për njoftimin e këtij urdhri institucioneve të varësisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme.

12. Urdhri nr. 152, datë 26.9.2025, "Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme", si dhe çdo dispozitë e përcaktuar në urdhra të tjerë, që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME

Besfort Lamallari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/INSTITUCIONI I VARËSISË)

Nr._____Prot. Tiranë, më
____.____.2025

AUTORIZIM

Për përfaqësimin në çështjen civile/administrative me palë:

Paditës: _____

E paditur: _____

Personi i tretë: _____

Objekti: _____

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", si dhe të urdhrit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr. ____ , datë _____ , "Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme";

VENDOSA:

Autorizimin e Z/Znj. _____, me detyrë _____, për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar kërkesëpadinë / ankimin / rekursin, si dhe për të përfaqësuar Ministrinë e Punëve të Brendshme, në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes civile / administrative me palë dhe objektin e sipërcituar, deri në shpalljen e vendimit në Gjykatën e Shkallës së Parë / në Gjykatën e Apelit / në Gjykatën e Lartë.

(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/DREJTUESI I INSTITUCIONIT)